



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 27, Datë 05.02.2013

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetare |
| - Z. Gerdjan Xhanari | Nënkryetar |
| - Z. Zamir Stefani | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, vazhdoi shqyrtimin e ankesës së ardhur me nr.prot 69 date 11.12.2012 nga një grup ish-studentësh të Universitetit Jo Publik “Vitrina”. Problematika e ngritur nëpërmjet kësaj anekese konsistonte në: Mënyrën e çregjistrimit nga Universiteti “Vitrina”, si dhe sigurimin e listës së programeve mësimore kundrejt pagesës të caktuar nga universiteti të paparashikuar në kontratën e lidhur ndërmjet këtyre palëve.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur,

VËREN SE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka filluar në mbledhjen e datës 21.12.2012. shqyrtimin e ankesës me nr.prot 69 date 11.12.2012 në drejtim të Universitetit Vitrina në lidhje me mënyrën e çregjistrimit, si dhe sigurimin e listës së programeve mësimore kundrejt pagesës.

Për vlerësimin e plotë të kësaj çështjeje, Komisioni i ka kërkuar Universitetit Vitrina nëpërmjet shkresës me nr. Protokolli 69/1, datë 26.12.2012, që brenda dates 11.01.2013 të jepte informacion në lidhje me problematiken e ngritur, përfshirë kopje të kontratave origjinale të lidhur midis Universitetit “Vitrina” dhe studentëve ankues, si dhe kopje për të gjitha llojet e kontratave standarde (tip) të përdorura nga Universiteti Vitrina që prej vitit 2010.

Komisioni konstatoi se deri më datë 05.02.2013 të zhvillimit të mbledhjes së tij të radhës, Universiteti Vitrina nuk ka paraqitur asnjë informacion me shkrim, apo ndonjë përgjigje zyrtare, me anë të së cilës për arsye objektive të kërkohej shtyrja e afatit apo të justifikohesh mosdhënia e informacionit.

Për sa më sipër, Komisioni mbështetur në nenin 52/1 të Ligjit nr. 9902 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” i ndryshuar, sipas të cilit “*Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji*”, konstatoi shkelje të këtij neni, si pasojë e mungesës së dhënies së informacionit të kërkuar nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 52, pika 4, nenin 52/1 dhe nenin 57 pikën 2/(d) të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “*Për mbrojtjen e konsumatorëve*”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6 (c), të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “*Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve*”.

VENDOSI:

1. Universiteti Vitrina, të gjobitet me shumën 300.000 lekë.
2. Universiteti Vitrina, të njoftojë menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

